

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR:

“TOP GEL” SHPK

Sot, me date 01.09.2025, personi i meposhtem:

Z.GIACOMO DI MASI atesia Giuseppe, amesia Angela, i datelindje 07.09.1967, lindur ne Putignano, Bari (BA), Itali dhe banues ne Via. Abate Eustasio.18, Castellana Grotte, 70013, Bari (BA), Itali, titullar I kartes se identitetit CA52825CQ, leshuar nga autoritetet Italiane ne daten 12.11.2018, me vullnet te lire themelon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar

“TOP GEL” SHPK, dhe harton per kete qellim Aktin e Themelimit te shoqerise me permbajtje si vijon:

Neni 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “TOP GEL” SHPK

Neni 2

Shoqeria deklarohet e krijuar nen ruajtjen e plote te normave qe permban ky akt.

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise, marrdheniet e saj me personat e trete juridike e fizike, vendas e te huaj, shteterore e private, rregullohen ne baze te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si dhe te akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij ligji. Shoqeria pergjigjet vetem per pasurine e saj.

Neni 4

Selia e shoqërisë do te jete ne Tirane, Rruga “Riza Cerova”, Ndertese Private Nr,68.Njesia Administrative 8, Tirane.

Neni 5

Veprimtaria e shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete Akt-Themelimi nuk mund te ndryshoje pa pelqimin e themeluesit te saj.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete : Konsulence ekonomike, financiare, menaxheriale, shitjeje, konsulence per kredimarrje ne sistemin bankar shqiptar, hartim plan biznesi, studim tregu, konsulence marketingu dhe promovimi aktiviteti te subjekteve, konsulence ne burimet njerezore, sherbime perfaqesimi ndaj subjekteve edhe individeve, vendas apo te huaj, ndermjetesim financiar edhe trajnime etj, per bizneset edhe individet, si dhe cdo sherbim tjeter financiar dhe kontabel te lejuar nga legjislacioni shqiptar per kete shoqerie qe ka lidhje me kete objekt veprimtarie.Import-Eksport per pjese mekanike te lejuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 7

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 .00 Lekë . Zoterohet nga ortakut i vetem qe themeluan kete shoqeri

Z. GIACOMO DI MASI me 100% te kuotave

Neni 8

Per nevoja te pune dhe te ushtrimit te aktivitetit te tyre, shoqeria mund te cel llogari ne cdo banke te njohur me ligj, qofte kjo private apo shteterore.



Neni 9

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete per nje kohe mbi 10 vjet dhe do filloje nga momenti i regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit, me perjashtim te rasteve kur mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose me vendim te asamblese se ortakeve.

Gjithashtu, shoqeria mund te shperndalet ne cdo kohe per rastet e parashikuara ne ligj.

Neni 10

Shoqeria perbehet nga ortaku I vetem: Z. GIACOMO DI MASI me 100% te kuotave,

Administrator I shoqerise eshte Z . GIACOMO DI MASI, i cili zgjidhet per nje afat 5 vjecar, me te drejte rizgjedhjeje.

Neni 11

Ortaku mban pergjegjesi vete per ruajtjen e karakterit te fshehtesise se aktivitetit dhe te dokumentacionit te shoqerise.

Neni 12

Organet e shoqerise jane:

- 1- Vendimi i Asamblese se Ortakeve.
- 2- Administrator i shoqerise, Z. GIACOMO DI MASI
- 3- Komisioni i Eksperteve Kontabel

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre percaktohen ne statutin bashkengjitur.

Neni 13

Per nevoja te punes, kjo shoqeri, mundt te punesoje edhe punonjes specialist te ndryshem, me kontrata te rregullta pune, sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 14

Dispozita me te hollesishme per shoqerine percaktohen ne statutin bashkengjitur.

Neni 15

Ky Akt-Themelimi u redaktua ne 5 kopje.

Administratori Z. GIACOMO DI MASI do te veproje ne emer te shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

ORTAKET

GIACOMO DI MASI





A stylized, handwritten signature in blue ink, appearing to read "K. Kovaçi".